



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
ORGAN QENDROR BLERËS
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më _____.07.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Dorashka 18424000-7, kova 39224330-0, sapun 33711900-6, letër higjenike 33761000-2,
Detergjentë 39831200-8, pastrues dyshemeje 39831300-9, pastrues tualeti 39831600-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 682 506 (shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtë) **leke pa TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Fier dhe buxheti i Qendrës Ekonomike të Arsimit Fier.

Fondi limit i ndare sipas autoriteteve kontraktore perfituese :

-Qendra Ekonomike e Arsimit Fier: **7 152 401** (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e një) **leke pa TVSH** dhe prej **8 582 881.2** (tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një pikë dy) **leke me TVSH**

-Bashkia Fier : **530 105** (pesëqind e tridhjetë mijë e njëqind e pesë) **leke pa TVSH** dhe prej **636 126** (gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) **leke me TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Fier (Organ Qendror Blerës), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 1 e nenit 83: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.”

Pika 2 e nenit 83: “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,”

si dhe në nenin 30 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **3 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me:

-Pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të

kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;

-Pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 1. ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

Pika 2/c: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;”

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga autoriteti kontraktor. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në procedurën e hapur të thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Duke qënë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, autoriteti kontraktor, duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave. Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **1 500 000 lekë pa TVSH** (*e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet*), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 1 500 000 lekë pa TVSH (*e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet*) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga aitoriteti kontraktor.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent, e vlefshme, për objektin që prokurohet (të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara), të lëshuar nga

Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatën e menaxhimit të cilësisë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për mallrat objekt i prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Certifikata për menaxhimin e cilësisë, ISO 9001:2015, është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e mallrave dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të Qendrës Ekonomike të Arsimit Fier, me urdhër nr.299 prot. datë 17.04.2025 (QEA) përcjellë me shkresën nr.299/6 prot, datë 28.05.2025 dhe protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 6476 prot., datë 30.05.2025, (bashkëngjitur DST në SPE), dhe nga specilistët e fushës të Bashkisë Fier, me urdhër nr.6862 datë 10.06.2025, përcjellë me shkresën nr.7054/1 prot., datë 13.06.2025, (bashkëngjitur DST në SPE), si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Bashkalidhur DST në SPE.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kerkese apo reference të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përveç kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e pershkrimit të kërkesave me kusht qe fjala “ose ekuivalent” përfshihet detyrimisht në këto specifikime.

Shenim : *Në çdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jetë përdorur si referencë emri i ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , perfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Njësia e Prokurimit:

Lefter Muskaj

Silvana Majkaj

Klodiana Hoxhaj